



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	15.06.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-107589/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	“KD EVENTS & Communications”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-107589/21 nga “KD EVENTS & Communications” me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike hapësira para Amfiteatrit nga data 28 Qershor 2021 deri më 11 Korrik 2021.

Qëllimi i kërkesës është lejimi i organizimit të ndeshjeve të kampionatit Evropian Euro 2020 ku aktiviteti do të zhvillohet me orare zyrtare të përcaktuara për Euro 2020 ku një pjesë e mysafirëve do të jen të ulur në vende të caktuara dhe do të ketë shërbim të pijeve për qytetarë.

Pas pranimit të shkresës të datës 28.06.2021 në emailin zyrtar aktiviteti do të zhvillohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës të Komunës së Prishtinës andaj, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në hapësirën para Amfiteatrit nga data 28 Qershor 2021 deri më 11 Korrik 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike, dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Aktiviteti të jetë në koordinim me policinë e Kosovës. Nëse nuk konfirmohet koordinimi i lartcekur ky pëlqim nuk vlen;
- Organizatori merr përsipër shpenzimet e energjisë elektrike për këtë aktivitet;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Pas përfundimit të aktivitetit të pastrohet sheshi dhe të kthehet në gjendjen e më parshme;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.